

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**BASHKINË VLORË (PARKINGJET)**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Vlorë**, me objekt: “Për auditimin e procedurave ligjore dhe miratimin me konçesion të administrimit të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë, në qytetin e Vlorës”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2014 deri më 30.07.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 65, datë 30.06.2015.

Bazuar në nenet 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 348/9, datë 30.06.2015, i ka rekomanduar z. Shpëtim Gjika, Kryetar i Bashkisë Vlorë, zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik është e pavlefshme, për arsye se nuk janë plotësuar kërkesat e ftesës për procedurën konkurruese të përcaktuar në DSKPPP.

Proçesi i përzgjedhjes së ofertuesit fitues nga komisioni i dhënies me konçesion/partneritet publik privat, është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, VKM nr. 575, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së konçesioneve/partneritetit publik privat" dhe DSKPP, duke favorizuar bashkimin e operatorëve ekonomik “*T.....c & .....Tr..... L.T.D*”.

Në këto kushte, komisioni i dhënies me konçesion/ppp ka vepruar në kundërshtim me nenet 19 dhe 23 të kreu III-*Procedura për dhënien e konçesioneve/partneriteteve publike private*, të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, VKM nr. 575, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së konçesioneve/partneritetit publik privat" dhe DSKPP, pasi duhet të formulonte propozimin e vendimit për ndërprerjen e procedurës së prokurimit, si pasojë e mosplotësimit të kriterëve për dhënien e kontratës së konçesionit, kriteret e përgjithshme të pranim/kualifikimit dhe kriteret e veçanta të kualifikimit .

-Përmbajtja e nenit 6-*dhënia e zonës së projekti*, në kontratën e konçesionit nr. 496, datë 06.02.2015 me objekt “Dhënia me konçesion e sistemimit dhe menaxhimit të parkimit në qytetin e Vlorës”, është në kundërshtim me pikën 3 të nenit 27, të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, për arsye se është ndryshuar tabela përmbledhëse e rrugëve të parkimit, duke shtuar oraret e parkimit në ditën e Shtunë.

Si rezultat i ndryshimit të kushteve të kontratës, shtesë të objektit të saj për parkimin në ditët e Shtunë, për 13 rrugë, për të gjithë periudhën e konçesionit, impakti financiar negativ që i krijohet buxhetit të njësisë vendore është 3,764,880 lekë, ndërsa subjekti privat përfiton me të pa drejtë shumën 184,479,120 lekë .

-Referuar të dhënave të studimit të fezibilitetit, komisioni i dhënies me konçesion/ppp, ka përllogaritur si tarifë fikse konçesionare vlerën 10 milionë lekë/vit, tarifë e cila nuk është përcaktuar sipas të ardhurave të studimit të fezibilitetit, pasi siç shprehet në faqen 33 të studimit. Nga komisioni i dhënies me konçesionit/ppp i Bashkisë është

kryer sondazhi mbi numrin e mjeteve të parkuara në kohë të ndryshme dhe kohës që këto mjete shfrytëzojnë vendparkimet, mbi bazën e së cilës janë përcaktuar dhe koeficientet e shfrytëzimit të parkimit të mjeteve në rrugë.

Duke marrë në konsideratë koeficientët e shfrytëzimit të vendparkimeve të përcaktuara nga komisioni i dhënies me konçesion/ppp (sipas studimit), të ardhurat e mundshme vjetore paraqiten në shumën 117,142,544 lekë dhe për periudhën 10 vjeçare (periudhë studimore) ato parashikohen në vlerën 1,171,425,440 lekë ose më pak se komisioni i dhënies me konçesion/ppp të Bashkisë ka evidentuar (953,065,440 lekë), prej 218,360,000 lekë.

Bazuar në nenin 35, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar dhe pikës 9, të vendimit të KB nr. 62, datë 26.11.2009, mbi bazën e së cilës është përcaktuar se detyrimi për tarifën e parkimit është në masën 10% e të ardhurave vjetore, rezulton se tarifa fikse konçesionare duhet të ishte në vlerën 11,714,254 lekë/vit, ose më shumë se sa komisioni i dhënies me konçesion/ppp ka përlogaritur në vlerën 1,714,254 lekë/vit dhe për periudhën 10 vjeçare (sipas studimit), më shumë në vlerën 17,142,544 mijë lekë, si një e ardhur e munguar në planifikimin e tarifës fikse konçesionare që përfiton Bashkia. Gjithashtu ky studim nuk përputhet me periudhën e konçesionit të miratuar me vendim të KB nr. 57, datë 11.12.2014, për një periudhë 15 vjeçare.

**Rekomandimi:** Drejtoria Juridike Bashkia Vlorë, të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore, për të bërë revokimin e kontratës së konçesionit nr. 496, datë 06.02.2015, me objekt “Dhënia me konçesion e sistemimit dhe menaxhimit të parkimit në qytetin e Vlorës”.

***Për arsye se:***

-Procesi i përzgjedhjes së ofertuesit fitues nga komisioni i dhënies me konçesion/ppp, është bërë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar dhe VKM nr. 575, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së konçesioneve/partneritetit publik privat" dhe DSKPP.

-Përmbajtja e kontratës së konçesionit është në kundërshtim me pikën 3 e nenit 27, të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, me ofertën e zgjedhur dhe me njoftimin e dhënies së kontratës, Dokumentet Standarde të Konçesionit Partneritet Publik Privat dhe ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomik të shpallur fitues.

-Llogaritja e tarifës fikse nuk është sipas të dhënave të studimit të fizibilitetit të bërë nga Bashkia dhe afatit kohorë të konçesionit të miratuar me vendim të KB nr. 57, datë 11.12.2014.

**Në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak**

**2. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Vlorë ka krijuar një marrëdhënie juridike-civile pa pasur të miratuar më parë në Këshillin e Ministrave listën përfundimtare të pasurive të cilat i kalojnë në pronësi e përdorim. Në kushtet kur Bashkia Vlorë, nuk rezulton në cilësinë e pronarit mbi pasurinë por administratorit të saj, si dhe nuk ka një miratim nga Këshilli i Ministrave, lejimin apo pëlqimin e përfaqësuesit të pronarit shtet të deritanishëm, pra të Ministrisë së Ekonomisë, nuk plotësohen kushtet ligjore për krijimin e marrëdhënies konçesionare, lidhjen dhe zbatimin e kontratës së konçesionit.

**Rekomandimi:**

**a.** Bashkia Vlorë me procedura ligjore, të revokojë kontratën e konçesionit nr. 496, datë 06.02.2015 me objekt “Dhënia me konçesion e sistemimit dhe menaxhimit të

parkimit në qytetin e Vlorës", deri në miratimin nga Këshilli i Ministrave të listës përfundimtare të kalimit në përdorim apo në pronësi të pasurive të paluajtshme.

**b.** Këshilli Bashkiak Vlorë, pas konstituimit të tij, në mbledhjen e radhës, të marrë në vlerësim e trajtim të gjitha shkeljet e konstatuara nga auditimi i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit e të paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në përfundim të shprehet lidhur me parregullsinë e vendimeve të mëparshme, të marra nga Këshilli Bashkiak dhe konkretisht të vendimit të KB nr. 45, datë 09.10.2014 dhe nr. 57, datë 11.12.2014.

### **Në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak**

**c.** Ministria e Ekonomisë dhe Turizmit, në referim të konstatimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në cilësinë e përfaqësuesit të pronarit shtet, të shprehet duke dhënë opinionin e saj, lidhur me parregullsitë e konstatuara në drejtim të cenimit nga Bashkia Vlorë të së drejtës të pronësisë dhe kufizimit të përdorimit të saj, si pasojë e veprimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe finalizuar me kontratën koncesionare nr. 496, datë 06.02.2015.

**Brenda muajt Korrik 2015**

## **B. MASA DISIPLINORE:**

Mbështetur në ligjin nr. 8927, datë 25.7.2002 "Për Prefektin", i ndryshuar, i rekomandojmë Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë t'i propozojë Këshillit të Ministrave, fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore "**Shkarkim nga detyra**" të parashikuar në nenin 4-*Emërimi dhe shkarkimi i prefektit*, për **znj. E. H.**, me detyrë Prefekt i Qarkut Vlorë dhe **z. D.H** me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Prefekturës së Qarkut Vlorë, për veprimet e mosveprimet e kryera në shkelje të ligjit dhe konkretisht të nenit 6-*Misioni i prefektit* dhe nenit 14-*Verifikimi i ligjshmërisë së akteve*, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, **pasi:**

Në shprehjen e ligjshmërisë mbi vendimet e Këshillit Bashkiak Vlorë nr. 45, datë 09.10.2014 "Për miratimin e dhënies së koncesionit për administrimin e shërbimi të parkimit me pagesë në rrugë" dhe nr. 57, datë 11.12.2014 "Për miratimin e kriterëve të dhënies së koncesionit për administrimin e shërbimi të parkimit me pagesë në rrugë", ka miratuar dhe shprehur se vendimet "**Vlerësohen të ligjshëm**", duke lejuar dhënien me koncesion të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë, edhe pse me dijeni të plotë në këtë marrëdhënie të krijuar Bashkia Vlorë nuk ka qenë në cilësinë e pronarit, por të administratorit të pasurisë, pasi nga Këshilli i Ministrave nuk është miratuar lista përfundimtare e pasurive të paluajtshme të cilat u kalojnë në pronësi apo përdorim bashkisë.

Për vendimin e KB nr. 57, datë 11.12.2014, ka dhënë miratim duke u shprehur se vendimi vlerësohet i ligjshëm edhe pse studimi i fisibilitetit është kryer për një afat 10 vjeçar, ndërsa miratimi në Këshillin Bashkiak është për një periudhë 15 (pesëmbëdhjetë) vjeçare.

Për vendimin nr. 57, datë 11.12.2014, akti nuk ka dalë nga Prefekti i Qarkut Vlorë, por nga Sekretari i Përgjithshëm i Prefekturës, me shënimin "**Në mungesë dhe me porosi**", veprim ky haptazi në tejkalim të kompetencave të tija ligjore, kjo pasi autorizimi i përdorur nuk përkon me rastin konkret, ku Urdhri i Prefektit nr. 68, datë 30.07.2014 "Për delegim kompetencash" ka pasur efekt vetëm për arsye të lejes vjetore të Prefektit, ndërsa nënshkrimi i vendimit të KB nr. 57, datë 11.12.2014, daton afro 5 muaj më pas.

Miratimi dhe konfirmimi mbi ligjshmërinë e akteve, vet ligji organik nr. 8927, datë 25.7.2002 “Për Prefektin”, ja atribuon këtë të drejtë, njëherazi detyrim vetëm Prefektit, si atribut i padelegueshëm prej tij.

Për vendimin e KB nr. 57, datë 11.12.2014, Prefekti edhe pse me dije të miratimit të ligjshmërisë nga Sekretari i Përgjithshëm, *veprim haptazi në kundërshtim me ligjin*, ka lejuar dhe ka konsideruar si të mirëqenë të gjithë këtë procedurë, duke mos marrë asnjë iniciativë ligjore për revokimin, shpalljen apo deklarinimin si të pavlefshëm.

Për mos marrjen e asnjë iniciative ligjore për të kundërshtuar gjyqësish të gjithë procedurën e kryer nga Sekretari i Përgjithshëm i Prefekturës, si veprim i kryer haptazi në kundërshtim me ligjin dhe në tejkalim të kompetencave.

Miratimi i konfirmimit të ligjshmërisë nga Prefektura e Qarkut Vlorë është bërë kur ka rezultuar se Këshilli Bashkiak dhe Bashkia Vlorë në tërësi nuk kanë përmbushur apo ezauruar procedurat sipas ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.03.2004, dhe konkretisht nenin 32-*Detyrat dhe kompetencat e këshillit komunal ose bashkiak* dhe nenin 35-*Seancat e këshillimeve me bashkësinë dhe e drejta e publikut për t'u informuar*, pasi Këshilli Bashkiak nuk mund të miratonte tjetërsimin apo dhënien në përdorim, pa gëzuar e disponuar ligjërisht tagrin e pronarit dhe pa ezauruar më parë procesin e informimit dhe dëgjësës të publikut.

Prefektura e Qarkut Vlorë ka miratuar konfirmim e ligjshmërisë, ku referuar dokumentacionit rezulton se sipas studimit “Për Konçesionin”, ka një afat kohorë 10 vjeçar, ndërsa me vendimin e KB nr. 57, datë 11.12.2014 afati i dhënies me konçesion nga 10 vjet është bërë për një periudhë 15 vjeçare, pra 5 vite më shumë, pa u ribërë një studim tjetër.

Prefektura e Qarkut Vlorë ka miratuar konfirmim e ligjshmërisë, kur Bashkisë Vlorë nuk i është miratuar kalimi nga përdorimi në pronësi i pasurive të paluajtshme, sipas ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”.

Në këto kushte, duke mos qenë në cilësinë e pronarit por administratorit konfirmimi i ligjshmërisë për dhënien me konçesion, pra tjetërsimin e përkohshëm të aseteve, nuk mund të kryhej pa miratimin dhe kalimin në pronësi të pasurive nën administrim, pra vendimmarrja mund të përligjej vetëm pasi të gëzoheshin e disponoheshin të drejta të plota ligjore.

Prefektura e Qarkut Vlorë ka miratuar duke konfirmuar ligjshmërisë e vendimit, ndërkohë që Këshilli Bashkiak dhe Bashkia Vlorë me vijimin e procedurave duke mos pasur në pronësi pasuritë e paluajtshme të llojit “*Rrugë*” të vëna në dispozicion të marrëveshjes konçesionare, ka vepruar në kundërshtim me nenet 27, 37 dhe 38, të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, duke mos zbatuar kriteret ligjore mbi rregullimin e pronësisë, për sa kohë Këshilli Bashkiak dhe Bashkia Vlorë nuk ka të miratuar kalimin nga përdorimi në pronësi të pasurive nën administrim, pra pa kaluar më parë nga administrator i pasurisë në atë të pronarit të saj.

Për sa më sipër me veprimet dhe mosveprimet e mësipërme Prefekti i Qarkut Vlorë dhe Sekretari i Përgjithshëm kanë vepruar në kundërshtim me neni 14, të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 “Për Prefektin”, i ndryshuar dhe pjesën VI-*Veprimtaria*

Administrative, neni 105 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

### **C. MASA ADMINISTRATIVE:**

Referuar parregullsisve dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurën me objekt “Dhënia me konçesion e sistemimit dhe menaxhimit të parkimit, në qytetin e Vlorës”, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në germën “ i ” e nenit 13-*Agjencia e Prokurimit Publik*, germa “a” e nenit 27-*Kufijtë monetarë*, nenit 72-*Kundërvajtjet administrative*, neni 28, pika 2 e nenit 38-*njoftimet të kreut V-Zhvillimi i Procedurave*”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pika 1-*Kufijtë monetarë* e kreu II-*Rregullat e Përgjithshme të Prokurimi*, pika 1 e nenit 79-*Sanksionet administrative*, pikave 1 dhe 2 të nenit 81-*Masat disiplinore*, të kreut X-*Sanksionet administrative dhe masat disiplinore*, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, **i rekomandojmë Drejtorit të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për **6 personat** e mëposhtëm:

- 1. Z. A.M**, me detyrë zv/Kryetar Bashkie, në profesionin Ing. ndërtimi, në cilësinë e kryetarit të komisionit të dhënies me konçesion/partneritet publik privat;
- 2. Z. I.B**, me detyrë zv/Kryetar Bashkie, në profesionin ekonomist, në cilësinë e anëtarit të komisionit të dhënies me konçesion/partneritet publik privat;
- 3. Z. A.B**, me detyrë zv/Kryetar Bashkie, në profesionin Ing .gjeolog, në cilësinë e anëtarit të komisionit të dhënies me konçesion/partneritet publik privat;
- 4. Z. G.SH**, me detyrë Drejtor Infrastruktura dhe Zbatimit të Projekteve, në profesion Ing. ndërtimi, në cilësinë e anëtarit të komisionit të dhënies me konçesion/partneritet publik privat;
- 5. Znj. M.M**, me detyrë specialist transporti, në profesion Ing. mekanik, në cilësinë e anëtarit të komisionit të dhënies me konçesion/partneritet publik privat;
- 6. Z. P.TH**, me detyrë përgjegjës i njësisë së prokurimit, në profesionin Jurist, në cilësinë e anëtarit të komisionit të dhënies me konçesion/partneritet publik privat.

#### ***Për arsye se:***

Nga shqyrtimi i dokumenteve të ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomik “T.....c & .....Tr..... L.T.D”., konstatohet se: Një pjesë e dokumenteve të ofertës nuk janë sipas fashikujve, pasi janë shkëputur nga lidhja dhe janë noterizuar si ekzemplarë të veçantë gjë që e bën dokumentin të pavlefshëm, pasi dokumentet e ofertës duhen të jenë në origjinal ose fotokopje e noterizuar.

-Bashkimi i operatorëve ekonomik “T...” dhe “O...”, **nuk kanë plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DSKPP**, duke u kualifikuar në kundërshtim me pikën 6 e nenit 25-*bashkimi i përkohshëm i shoqërive*, VKM nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçesion/partneritet publik privat”. Sipas nenit 2, interesat e bashkimit të operatorëve ekonomik janë ndarë 98% për TIS dhe 2% për OTI, por që duhet të plotësoheshin në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes.

Dokumenti noterial nr. 10460 datë 04.01.2015, me objekt “Çertifikatë e pronësisë intelektuale”, **nuk plotëson kriterin e kërkuar nga autoriteti kontraktor**, pasi

dokumenti nuk është lëshuar nga institucionet shtetërore të certifikimit në shtetin e origjinës.

Dokumenti bashkëlidhur aktit noterial nr. 10466, datë 04.01.2015, është shkëputur nga dokumentet noteriale nr. 10465, datë 04.01.2015, gjë që e bën atë të pa vlefshëm, pasi nuk është origjinal dhe kualifikimi i operatorit “O..T.... In... L.T.D” është në kundërshtim me SKPPP.

Dokumenti në gjuhën shqipe datë 29.07.2012 me objekt “Në vëmendje të interesuarit” **nuk është noterizuar në shtetin e origjinës**, për rrjedhojë dokumenti **nuk është origjinal**, në këto kushte operatori ekonomik (OE) duhet të ishte skualifikuar për mosplotësim të kërkesave të parashikuara nga autoriteti kontraktor në DSKPPP.

Dokumenti datë 06.01.2015, lëshuar nga KPMG, për O.T...IN.... L.T.D, me objekt “Detyrimet aktuale/korrent me autoritetet Izraelite të taksave”, **nuk është konform kërkesave të autoritetit kontraktor** të përcaktuara në pikë 2/a, të Kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit të Shtojcës 9, DST, për arsye se nuk është lëshuar nga autoritetet e shtetit të origjinës, në këto kushte operatori ekonomik duhet të ishte skualifikuar për mosplotësim të kërkesave të parashikuara.

Dokumenti datë 07.01.2015, lëshuar nga KPMG, për “O.T. In... L.T.D”, me objekt “Detyrimet e papaguara në Autoritetet Tatimore të Izraelit”, **nuk është konform kërkesave të autoritetit kontraktor** të përcaktuara në pikë 2/a të Kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit të Shtojcës 9, DST, për arsye se nuk është lëshuar nga autoritetet shtetërore, në këto kushte operatori ekonomik duhet të ishte skualifikuar për mosplotësim të kërkesave të parashikuara.

Dokumenti i noterizuar me nr. 10462 datë 04.01.2015 me objekt “Çertifikatë e menaxhimit të të dhënave financiare në përputhje me Aktin mbi transaksionet e entitetet publike” hartuar më datën 10.06.2014, për operatorin “O..T.... In.... L.T.D”, **nuk plotëson kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në DSKPP**, për arsye se nuk ka të dhëna mbi vlerën e xhiros të realizuar gjatë dy viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit ekonomik, në këto kushte operatori ekonomik duhet të ishte skualifikuar për mosplotësim të kërkesave të parashikuara.

Dokumenti datë 07.01.2014 me objekt “deklaratë përputhshmërie”, nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën 9 të DSKPPP, ***për arsye se shoqëria nuk ka paraqitur dokument/dëshmi lidhur me deklarinimin e mos lëshimit të këtyre vërtetimeve nga institucione të shtetit të origjinës, ofertuesit duhet të paraqesin vërtetim nga Dhoma e Tregtisë së vendit të origjinës – duke evidentuar faktin se ndonjë apo të gjitha vërtetimet e kërkuara në këtë Aneks nuk lëshohen nga ndonjë institucion publik përgjegjës***, në këto kushte operatori ekonomik duhet të ishte skualifikuar për mosplotësim të kërkesave të parashikuara.

Dokumenti datë 08.01.2014 me objekt “deklaratë përputhshmërie”, nuk plotëson kriteret e përcaktuara në shtojcën 9 të DSK, për arsye se nuk shoqëria nuk ka paraqitur dokument/dëshmi lidhur me deklarinimin e mos lëshimit të këtyre vërtetimeve nga institucione të shtetit të origjinës, ofertuesit duhet të paraqesin vërtetim nga Dhoma e Tregtisë së vendit të origjinës—duke evidentuar faktin se ndonjë apo të gjitha vërtetimet e kërkuara në këtë Aneks nuk lëshohen nga ndonjë institucion publik përgjegjës, në këto kushte operatori ekonomik duhet të ishte skualifikuar për mosplotësim të kërkesave të parashikuara. Dokumenti me objekt “Pasqyrat financiare e konsoliduar deri më 31.12.2013” të shoqërisë “T... LLC”, nuk plotëson kërkesën e Bashkisë të përcaktuar germën “a” e pikës 2.2-*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*, për arsye se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumente/prova e dëshmi për vitin

2012, në këto kushte operatori ekonomik duhet të ishte skualifikuar për mosplotësim të kriterëve të parashikuara.

Dokumenti noterial nr. 10465, datë 04.01.2015 me objekt “Kontratë për blerje pajisje Easy Park dhe/ose përdoruesit e sistemit Easy/Park për përdorim për pagesën e tarifave të parkimit në Konte” nënshkruar më datë 16.01.2014 ndërmjet O... Amerika, Inc dhe Th..... të Kontesë Arlington, Virxhinia) Th....i, nuk është në emër të shoqërisë O.T.. In..... L.T.D, si dhe ofertuesi nuk ka paraqitur dokumente për shoqëri të lidhura/komandite, në këto kushte operatori ekonomik duhet të ishte skualifikuar për mosplotësim të kriterëve të parashikuara.

Dokumenti noterial nr. 10463, datë 04.01.2015 me objekt “Kontratë për opsion pagesash të alternuara për parkim me pagesë” nënshkruar më datë 17.10.2011 ndërmjet OTI, Amerika, Inc dhe qytetit të Austinit, nuk është në emër të shoqërisë “O..T...In,... L.T.D”, si dhe nuk ka dokumentet për shoqëri të lidhura, në këto kushte operatori ekonomik duhet të ishte skualifikuar për mosplotësim të kriterëve të parashikuara.

Dokumenti noterial nr. 10466, datë 04.01.2015 me objekt “Kontratë për instalim, mirëmbajtje dhe operacionet teknike e financiare të sistemit Easy/Park” nënshkruar më datë 13.08.2013 ndërmjet O..., Amerika, I. korporatë nga New Jersey dhe qytetit të Lynchburg, **nuk është në emër të shoqërisë** në këto kushte operatori ekonomik duhet të ishte skualifikuar për mosplotësim të kriterëve të parashikuara.

Dokumenti/kontratë bashkëpunimi datë 15.03.2014, me objekt “*Implementim i sistemit të Monitorimit të Shitjeve dhe monitorimit të parkingut të kompanisë*”, nuk plotëson kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në DSKPPP, gjë që operatori ekonomik duhet të ishte skualifikuar për mosplotësim të kriterëve të parashikuara.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik nuk kanë paraqitur dokumente/prova në lidhje me plotësimin e Kapacitetin teknik të DSKPP, pasi duhet të kishte paraqitur një demonstrim konkret të sistemit me të gjitha funksionet e tij përpara Komisionit të Dhënies së Konçesionit në ditën e hapjes së ofertave, përcaktuar në DSKPPP, gjë që operatori ekonomik duhet të ishte skualifikuar për mosplotësim të kriterëve të parashikuara.

Bashkimi i operatorëve ekonomik nuk kanë plotësuar kërkesat mbi Kapacitetin teknik të DSKPPP, që ofertuesi duhet të paraqesë gjithashtu dokumentacion ligjor që vërteton pronësinë intelektuale/ të autorit dhe ose të drejtën e përdorimit mbi pronësinë intelektuale/të autorit mbi zgjidhjen teknologjike të propozuar, në këto kushte operatori ekonomik duhet të ishte skualifikuar për mosplotësim të kriterëve të parashikuara.

Sa trajtuar më sipër komisioni i dhënies së konçesion/partneritet publik privat kanë vepruar në kundërshtim me nenet 19 dhe 23, kreu III “Procedura për dhënien e konçesioneve/partneriteteve publike private”, të ligjit 125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, VKM nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së konçesioneve/partneritetit publik privat” dhe DSKPP, **pasi duhet të formulonte propozimin e vendimit për ndërprerjen e procedurës së prokurimit si pasojë e mosplotësim të kriterëve për dhënien e kontratës së konçesionit (kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit dhe kriteret e veçanta të kualifikimit).**

Veç kësaj përmbajtja e nenit 6-dhënia e zonës së projektit, në kontratën e konçesionit nr. 496, datë 06.02.2015 me objekt “Dhënia me konçesion e sistemit dhe menaxhimit të parkimit në qytetin e Vlorës”, është në kundërshtim me pikën 3 e nenit 27, të ligjit, Dokumentet Standarde të Konçesionit Partneritet Publik Privat dhe

ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomik “T.....c & .....Tr..... L.T.D”, për arsye se; është ndryshuar tabela përmbledhëse e rrugëve të parkimit, duke shtuar oraret e parkimit në ditën e Shtunë.

Si rezultat i ndryshimit të kushteve të kontratës, shtesë të objektit të saj për parkimin në ditët e Shtunë, për 13 rrugë (për periudhën e konçesionit), dëmi ekonomik i krijuar buxhetit të njësisë vendore është **3,764,880 lekë**, ndërsa subjekti privat përfiton me të pa drejtë **184,479,120 lekë**.

Përmbajtja e paragrafit “...Autoriteti kontraktor dhe konçesionari angazhohen të konsiderojnë zgjerimin e zonës së projektit, duke negociuar termat përkatëse, në sajë të performancës së kënaqshme të konçesionit dhe interesit publik”, është në kundërshtim me pikën 3 të nenit 27-*Përmbajtja e kontratës dhe DSKPPP*.

Përmbajtja e nenit 13-*Ndryshimi i tarifave të aplikueshme nga konçesionari dhe nenit 15-shoqëria e projektit-marrëveshjet e konçesionarit të kontratës*, është në kundërshtim me pikën 3 të nenit 27-*përmbajtja e kontratës*, ku citohet se, “*Kontrata duhet të hartohet në përputhje me dokumentet e tenderit, me informacionet që gjenden në njoftimin e kontratës, me ofertën e zgjedhur dhe me njoftimin e dhënies së kontratës*” dhe *DSKPP*.

Përmbajtja e nenit 26-*ngjarje të qenies në vonesë nga ana e Konçesionit*, në kapitullin “*Mbarimi i Marrëveshjes*” është në kundërshtim me *DSKPPP*.

Përmbajtja e nenit 29-*pagesat e mbarimit të marrëveshjes*, ku përcaktohet se: “*Në rastin e mbarimit të kësaj marrëveshje, Autoriteti Kontraktues do t'i paguaj Konçesionarit kompensim për të gjithë periudhën e mbetur të konçesionit referuar të ardhurave sipas plan biznesit plus një penalitet minimalisht 10 (dhjetë) 10% të kësaj shume*”, është në kundërshtim me pikën 3 të nenit 27-*Përmbajtja e kontratës*, ku citohet se; “*Kontrata duhet të hartohet në përputhje me dokumentet e tenderit, me informacionet që gjenden në njoftimin e kontratës, me ofertën e zgjedhur dhe me njoftimin e dhënies së kontratës*” dhe *DSKPP*.

**Kontrata e konçesionit, nuk është hartuar nga komisioni i dhënies me konçesion/partneritet publik privat ose nga Drejtoria Juridike**, veprime në kundërshtim me pikën 3/b, nenin 25, kreu III-*Kompetencat dhe detyrat e administratës së Bashkisë* të “Rregullores të organizimit, funksionimit, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Vlorë” e miratuar VKB nr. 11, datë 29.03.2012, ku citohet se; “Drejtorja Juridike i jep ndihmë juridike Drejtorive apo zyrave të Bashkisë për hartimin e kontratave e marrëveshjeve të ndryshme, në lidhje me realizimin e funksioneve të Bashkisë”.

Shpallja e tarifës së konçesionit është në kundërshtim me nenet 23 dhe 29, të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, neni 7, të VKM nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçesion/ppp”, nenit 28, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, me ndryshime dhe pikës 2 të kreut II, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, pasi duhej shpallur vlera e konçesionit, për të cilën është kërkuar dhe sigurimi i ofertës dhe jo tarifa e konçesionit.

Gjithashtu prokurimi nuk është shpallur në një nga gazetatat me shpërndarje në Europë, nisur nga kufiri i lartë monetar që paraqet (953,064 mijë lekë), veprim në kundërshtim me ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, germa “a” të nenit 27-*Kufijtë monetarë*, pika 2 të nenit 38-*njoftimet të kreut V-Zhvillimi i Proçedurave*, si dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, pika 1-*Kufijtë monetarë* e kreu II-*Rregullat e Përgjithshme të Prokurimi*.



Nga Bashkia Patos, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë në proces zbatimi.**

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Kristaq Gjurgjaj, Rysin Xhaja dhe Shefki Jaupi, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**